L I G J
Nr.7926, datë 20.4.1995

PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji, me termat vijuese:

a) "Ndërmarrje shtetërore", që më poshtë do të quhen "ndërmarrje", kuptohen gjithë personat juridikë publikë të themeluar sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1993 "Për ndërmarrjet shtetërore".

b) "Shoqëri shtetërore", që më poshtë do të quhen "shoqëri", kuptohen gjithë personat juridikë publikë, të cilët do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe që do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 3

Të gjitha ndërmarrjet shtetërore do të transformohen në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Çdo ndërmarrje mund të transformohet në një ose disa shoqëri anonime ose me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar do të krijonë këshill mbikqyrës.

Neni 4

Shteti, si zotërues i vetëm i kapitalit të shoqërive përfaqësohet nga Ministria e Financave, e cila nënshkruan edhe kapitalin themeltar të këtyre shoqërive.

Ministria e Financave ushtron të drejtën e pronarit përsa i përket transformimit të ndërmarrjes në shoqëri si dhe për privatizimin e tyre tërësisht apo pjesërisht.

Neni 5

Pranë Ministrisë së Financave krijohet "Drejtoria e shoqërive publike". Në përbërje të Drejtorisë së Shoqërive Publike përfshihen të gjitha drejtoritë e sotme të privatizimit pranë ministrive dhe institucioneve përkatëse, si dhe nënkomisionet e privatizimit pranë organeve të pushtetit lokal.

Statusi dhe kompetencat e Drejtorisë së Shoqërive Publike caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

"Drejtoria e shoqërive publike" drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Neni 7

Regjistrimi i shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, duhet të kryhet brenda datës 31.8.1995

Çdo ndërmarrje shtetërore që pas kësaj date nuk është transformuar e regjistruar si shoqëri, vendoset nën kujdestarinë e Drejtorisë së shoqërive publike.

Ministri i Financave ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar transformimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore si shoqëri tregtare, brenda afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 8

Organet drejtuese të shoqërive anonime janë:

- Këshilli mbikëqyrës
- Drejtori i përgjithshëm

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 deri në 9 anëtarë, të cilët nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri. Një e treta e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës emërohet nga organi i vartësisë së ndërmarrjes shtetërore që është transformuar, kurse dy të tretat nga Ministria e Financave.

Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga këshilli mbikëqyrës kur për të bien dakord jo më pak se tre të katërtat e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrjen në këshillin mbikëqyrës dhe shpërblimet e jashtëzakonshme për shërbimet a detyrat që u besohen anëtarëve të këshillit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, nuk zbatohet për shoqëritë anonime, sa kohë që shteti do të jetë i vetmi aksionar në këto shoqëri.

Neni 9

Shoqëria që krijohet si pasojë e transformimit të ndërmarrjes, merr përsipër të gjitha detyrimet që ndërmarrja ka pasur përpara transformimit dhe përgjigjet ndaj të tretëve me pasurinë e saj.

Të gjitha kontratat e lidhura me të tretët nga ndërmarrja përpara transformimit mbeten në fuqi edhe për shoqërinë që krijohet.

Neni 10

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe për sa kohë që shteti do të jetë i vetmi aksionar ose ortak i shoqërive, organet drejtuese të ndërmarrjeve a shoqërive nuk kanë të drejtë të autorizojnë ose të kryejnë shitje të pasurive të paluajtshme dhe të makinerive e pajisjeve, të marrin hua dhe kredi, të nënshkruajnë kontrata të reja për dhënien me qira të objekteve, si dhe të krijojnë shoqëri të përbashkëta.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për ndërmarrjet që janë parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Neni 11

Këshilli i Ministrave miraton statusin tip, aktet e tjera tip të themelimit si dhe kriteret e vlerësimit të kapitalit themeltar të shoqërive që do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve.

Neni 12

Shpenzimet për procesin e transformimit të ndërmarrjeve në shoqëri, si dhe regjistrimi i tyre sipas dispozitave në fuqi, përballohen nga vetë ndërmarrja.

Neni 13

Neni 191 dhe pika 4 e nenit 297 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregare”, nuk zbatohen për shoqëritë shtetërore.

Neni 14

Nenet 94 dhe 95 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” shfuqizohen.

Neni 15

Ligji nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, do të ketë fuqi për sa kohë që ndërmarrjet nuk janë transformuar në shoqëri, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe.

Neni 16

Ky ligj nuk zbatohet për bankat shtetërore të nivelit të dytë dhe për institutet e sigurimeve shtetërore.

Neni 17

Të gjitha ndërmarrjet ekonomike me kapital tërësisht shtetëror që do të krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të themelohen e regjistrohen si shoqëri.

Neni 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi më 15 maj 1995.

Shpallur me dekretin nr.1090, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha